

**Ma. Luan TETAJ**

## **GJENOCIDI MALAZEZ NË GJAKOVË NË VITIN 1913**

Shqiptarët gjatë historisë u përballën me beteja të përgjakshme kundër shtypjes, dhunës dhe mizorive që bënin pushtuesit për shkombëtarizimin dhe shfarosjen e popullit shqiptar. Është shumë vështirë të gjendet një komb tjetër që i janë bërë aq shumë pengesa dhe padrejtësi sa popullit shqiptar. Gjatë historisë shqiptarët kanë treguar fuqi të jashtëzakonshme duk i përballuar ekspansionit dhe gjenocidit nga tri shtetet fqinjë në të njëjtën kohë: të shtetit malazez, serb dhe grek. Në fillimin të shekullit të XX-të në qendër të Evropës, jo shumë larg qendrave më të rëndësishme të kulturave, nuk u ndërmor asgjë për t'i parandaluar krimet malazeze, përshkrimi i të cilëve është shumë i rëndë.

Gjakova shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës, ka pozitë qendrore në Rrafshin e Dukagjinit, në lindje kufizohet me komunën e Rahovecit, në përmendim e jugperëndim me rrethin e Tropojës, në veri e verilindje përkatësisht me komunën e Deçanit dhe Klinës, dhe në juglindje me komunën e Prizrenit.<sup>1</sup>

Ushtria malazeze e pushtoi Pejën më 30 tetor të vitit 1912, ndërsa Gjakovën më 4 nëntor.<sup>2</sup> Gjakova ishte e ndarë në pjesë malazeze dhe serbe, ndërsa pas qershorit të vitit 1913 Gjakovën do ta administrojnë Mali i Zi si kompromis të mbetjes së Shkodrës brenda kufijve të Shqipërisë.<sup>3</sup> Me pushtimin e këtyre dy qendrave u okupua pjesa me e madhe e Rrafshit të Dukagjinit. Postin e komandantit të Qarkut Ushtarak të Pejës e ushtronte Lakiq Vojvodiq, ndërsa komandant i xhandarmërisë për rajonin e Gjakovës ishte Sava Memedoviq. Në Gjakovë kishin operuar forcat ushtarake dhe policore malazeze të cilat kanë kryer shumë abuzime kundër popullsisë të pambrojtur dhe të pafajshme shqiptare. Me pushtimin e Pejës dhe Gjakovës ushtria malazeze pa u hamendur fare filloi krimet dhe terrorin ndaj popullatës shqiptare.<sup>4</sup>

Drejtoria rajonale e Pejës, 3 shkurt 1913 i kishte dërguar telegram ministrit të Punëve të Brendshme të Malit të Zi në Cetine z. Plamenac. Në

<sup>1</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor Enciklopedik shqiptar 1*, Tiranë, 2008, f. 810.

<sup>2</sup> Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913 (Dokumente)*, Prishtinë, 1996, f. 35

<sup>3</sup> Isa Bicaq, *Vendosja e pushtetit malazez në viset e pushtuara 1912-1913, Konferencë shkencore, Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas, Prishtinë, 13-14 shtator 2012, (në dorëshkrim)*.

<sup>4</sup> Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913... f. 35.*

lidhje me urdhrin tuaj numër 503, me të cilin shkurtohet personeli i kësaj drejtorie, kam nderin t'ju njoftoj që ky vend është i tillë që me një numër të caktuar personeli është e pamundur të kryhet shërbim policor, sepse qyteza e këtushme ka konstruksion të çuditshëm, konstruksioni i saj është i atillë që nuk mund të sqarohet e të përshkruhet. Gati të gjitha shtëpitë kanë oborr dhe shfrytëzohen për fshehjen e keqbërësve çerdhja e të cilëve gjendet këtu pa e përjashtuar edhe Gjakovën. Në Gjakovë është një pjesë e vogël serbësh por edhe këtu elementi Serb është i vogël, dhe është shumë e lehtë t'u bëhet keq, kur dihet se secili shqiptar në Gjakovë i ka së paku dy pushkë me fishekë. I gjithë ai popull i ka fshehur armët nën tokë. Në Gjakovë të merren peng 150 deri në 200 persona. Në përgjithësi, këtu është e nevojshme që personeli të jetë sa më i përgatitur dhe energjik i cili do të mund t'i kryej detyrat e tij në mënyrë të duhur.<sup>5</sup>

Kishte raste që pushteti malazez njerëzit e pafajshëm i kishte burgosur duke i mbajtur si pengje me qëllim që të tregonin së kush nga bashkëvendësit e tyre posedonte armë, dhe të tregonin vendin së ku i kishin fshehur ato. Në telegramin e R. Veshoviqit Janko, dërguar Vukotiqit në Podgoricë thuhet: «Një pjesë e madhe e njerëzve nuk i dorëzojnë armët, unë i burgosa shkruante Veshoviqi në telegramin e tij, dhe u tregova së nëse nuk tregojnë dhe nuk gjinden armët e shokëve tuaj ju do të vazhdoni të jeni të burgosur».<sup>6</sup>

Kur filloi mbledhja e armëve nga forcat malazeze brenda pak ditëve në Gjakovë u dorëzuan 490 pushkë,<sup>7</sup> pasi që çarmatimi nuk i kishte dhënë rezultatet e pritura, autoritetet malazeze filluan të përdorin metodën e marrjes së njerëzve peng dhe internimin e shqiptarëve në kampet e përqendrimit në Podgoricë dhe Nikshiq. Numri më i madh i internuarve ishte nga Peja dhe Gjakova. Në muajin shkurt të vitit 1913 numri i shqiptarëve në këto kampe arriti deri në 323 veta, ndërsa në mars nga Gjakova u internuan në Nikshiq edhe 233 vetë. Këta njerëz ishin më autoritet dhe ndikim të madhe në rrethin ku jetonin. Autoritetet malazeze i përdorën këto metoda më qëllim të eliminimit të elitës dhe të shpejtimit të procesit të çarmatimit të popullsisë në qytetin e Gjakovës.<sup>8</sup> Pengjet e marra janë mbajtur në internim më javë e muaj, ata liroheshin në bazë të kërkesave për falje duke ju drejtuar mbretit Nikolla. Një pjesë e pengjeve të liruara pas kthimit në vendin e tyre e ndërruan fenë, një pjesë e tyre është larguar për në Shqipëri ndërsa pjesa tjetër është nënshtruar sundimit malazez.<sup>9</sup>

<sup>5</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Državni Arhiv Cerne Gore-DACG-Cetinje, Ministarstvo Inostranih Djela-MID (1913)

<sup>6</sup> Isa Bicaç, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze (1881-1914)*, Prishtinë, 2003, f. 176.

<sup>7</sup> Zekeria Çana, *Gjenocidi i Malit të Zi: mbi popullin shqiptar 1912-1913...*, f. 37.

<sup>8</sup> Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 17.

<sup>9</sup> Isa Bicaç, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze...*, f. 177.

Në telegramin e Mbretërisë së Malit të Zi, Ministria e Punëve të Brendshme numër 1397 të datës 24 mars 1913 Cetine, dërguar ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë-Cetine, nderë të tjera thuhet, sipas raportit të pranuar nga Gjakova, ende para arritjes së delegatëve tanë atje, Konsulli austriak i ka joshur për vete gjashtëmbëdhjetë nga ata Arnautët rimokatolik, të cilët kishin kaluar në fenë ortodokse dhe është duke i mbajtur të mbyllur, dhe pse tre prej tyre kanë arritur të arratisen dhe i kanë lajmëruar autoriteteve tona se si i kanë mashtruar dhe si iu kanë ofruar nga njëqind lira turke për të deklaruar që janë bërë ortodoks me dhunë.

Lutet Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë që për faktet e lartpërmendura ta vejë në dijeni si përfaqësinë diplomatike të Austro-Hungarisë ashtu edhe atë të Italisë me vërejtjen që veprimet e tilla janë në kundërshtim me punën objektive të komisionit, i cili ka marrë për detyrë që punën e përbashkët ta shqyrtoj dhe konstatoj me ndërgjegjeje.

Në telegramin lëshuar nga Mbretëria e Malit të Zi, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e administratës numër 1265 të datës 15 mars 1913 Cetine, për Vojvodën Gavro Vukovic – Kryetar i Këshillit Shtetëror në pension Cetine, këshilli i Ministrave të Mbretërisë në mbledhjen e tij ju ka caktuar juve dhe z. Ljuba Gjakiçin, anëtarin e Gjykatës së Lartë të Mbretërisë, që në bazë të marrëveshjes së arritur me Qeverinë e Mbretërisë së Austro-Hungarisë, të shkoni në Gjakovë dhe së bashku me delegatët e Qeverisë së Mbretërisë: të shquarin Ipushkvin e Prizrenit Mjedën dhe z. nën - Konsullin Pedl në vendin e ngjarjes të vërteton me komision, a ka pasur apo jo dhunë nga ana e autoriteteve Malazeze apo dikujt tjetër ndaj katolikëve të Gjakovës, të cilët kanë kaluar në fenë ortodokse, dhe të bëni hetim, të konstatooni, nëse prifti katolik, Franjevac O. Luigji Pali është vrarë për shkak të qëndrimit të kundërt ndaj shtetit, dhe a i kanë shkelur autoritetet tona dhe në çfarë mase i kanë tejkaluar urdhëratë ligjore.<sup>10</sup>

Në telegramin dërguar Krahinari J. Plamenac – Gjakovë, Ministrit Plamenac – Cetine thuhet: pasi erdha këtu e pashë si nevojë të madhe që nga Gjakova dhe rrethina të dërgohen atje si pengje së paku 300 njerëz sepse kjo do të ndikonte shumë në çarmatimin, rregullin dhe qetësinë në këtë anë. Lidhur më këtë ju kam informuar kohë më parë nga Peja. Mësa kam parë, deri me arritjen e kapitenit Çukiq këtu, nuk është bërë asgjë në të mirën e përgjithshme. Duke ju referuar një telegrami tjetër thuhet: është e domosdoshme që këtu të dërgohen nga Berana një batalion ushtarësh sepse ushtria po i mbledh armët nëpër fshatra, trupat e këtushëm janë të pamjaftueshëm. Brenda dy ditëve në Gjakovë dhe rrethinë u mblodhëm 373 pushkë dhe 20 revolver. Shpresojmë së kjo anë brenda njëzetë ditëve do të çarmatoset. Është e mundshme së armët mund t'i transportojnë

<sup>10</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Državni Arhiv Cerne Gore-Cetinje-DACG, Ministarstvo Unutrosnjnin Dvela Upravno Odelsnije-MUDUO, (1912-1914).

(shqiptarët) në Shalë, Curraj, Nikaj dhe Mertur, vende këto që përveç Currajve janë nën territorin e pushtimit serb, më të cilin janë marrë vesh që edhe serbet t'i hynin çarmatimit. Në këtë mënyrë mund të ndërpritet rruga e transportimit të armeve dhe komunikimit, prandaj mbremë i dërgova dy çeta ushtarësh në Junik, njërin nga vendet më të rrezikshme dhe më të forta të viseve të sapo çliruara.<sup>11</sup> Një nga telegramet dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme në Cetine shkruhet, çarmatimi po bëhet si në rrethin e Gjakovës ashtu edhe në atë të Pejës më shumë vështirësi, por ata po paguajnë shumë shtrenjtë sepse po i blejnë armët në Shqipëri. Shpresoj së do të heqin dorë së shpejti sepse do ta kenë shumë vështirë. Banorët kur e panë që nuk kishin rrugëdalje tjetër një pjesë arriti të ik ndërsa pjesa tjetër është duke e përqaftuar konvertimin.<sup>12</sup>

Organet pushtuese malazezet i intensifikuan krimet kur në Ponashec si shenjë hakmarrje të dy ushtarëve të vranë dhe një të plagosur, ushtria malazeze e udhëhequr nga Veshoviqi pas bombardimit të fshatit me topa dhe u sigurua së nuk do të haste në rezistencën e banorëve të fshatit, filloi t'i nxjerr nga shtëpitë meshkujt duke i lidhur më shokat e tyre dhe i dërgoi në fusha ku në mënyrë mizore u pushkatuan 87 burra.<sup>13</sup> Gazeta politika e datës 3 nëntor 1912 shkruan, në rrethin e Gjakovës në një familje ushtria i kishte masakruar dhe pastaj i kishte djegur 72 shqiptarë. Gjenocidi i ushtrisë malazeze vazhdonte në mënyrë sistematike edhe në fshatrat si në Fshaj, Ujz, Morinë, Skivjen etj., ushtarët vranë 580 shqiptarë. Vetëm në fshatin Skivjan u vranë dhe u masakruan 26 familje shqiptare.<sup>14</sup> Gjatë kësaj kohe u dogj më themel edhe fshati Batushë, fshat ku nuk u kursyen pleqtë madje as fëmijët të cilët u likuiduan në mënyrë mizore. Krime të ngjashme u bënë dhe në fshatin Cermjanë, dhe ka fundi i marsit sulmohet i tërë regjioni i Hasit, sikur në vendet tjera edhe këtu u likuiduan shumë shqiptar.<sup>15</sup> Paralelisht me krimet e kryera në këto fshatra u dhunuan edhe 36 gra, ndërsa para banorëve u therën edhe 8 pleq në moshën 80 vjeçare.<sup>16</sup>

Sipas lajmeve autentike të arritura në konsultën imperiale mbretërore në Prizren, Ati Françeskan Luigj Palaj është ndaluar në Pejë nga autoritetet malazeze dhe është transportuar i lidhur në Gjakovë, ku është gjetur i vranë më 7 mars të vitit 1913. Kjo vrasje ka indinjuar në masë të madhe popullatën dhe klerin katolik dhe ka nxitur gjithashtu botën katolike të Monarkisë, fuqi mbrojtëse e shqiptarëve katolikë.

11 Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913*,... f. 126.

12 Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Državni Arhiv Cerne Gore-DACG-Cetinje, Ministarstvo Imostranih Djela-MID (1913).

13 Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913*,... Prishtinë, 1996, f. 50.

14 Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)*, Prishtinë, 2001, f. 17.

15 Gazeta Shkëndija, e përjavshme arsimore-pedagogjike dhe shoqërore, Nr. 44 viti XXI, Prishtinë, 1991, f. 16.

16 Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror*,... f. 17.

Kam urdhër t'i kthej qeverisë shkresën nr. 377 të datës 4 mars të këtij viti për arsye të papajtueshmërisë së përmbajtjes së saj. Qeveria konsideron në mënyrë të qartë të dhëna në lidhje me vrasjen e Atit Palaj si krejtësisht të pamjaftueshëm dhe duhej të kërkoj që të hapet një hetim i ri dhe një përfaqësues i mbrojtjes së pushtetit të ftohet të marrë pjesë në hetime. Qeveria duhej të protestojë kundër argumentimit të kësaj shkrese që përfshin një shkelje të drejtave të mbrojtjes së monarkisë mbi shqiptarët katolikë kundër përdorimit nga ana e Malit të Zi, të drejtat e sovranitetit të cilat, e dinë që nuk janë brenda kompetencave të një pushteti okupes.<sup>17</sup>

Si vazhdimësi e shkresës Nr. 84 të datës 12 mars në lidhje me vrasjen e Luigj Palajt në Janosh afër Gjakovës, sipas ngjarjeve të reja të pranuar, sa i përket veprimeve të trupave malazeze në terren mbretëria konsideron së udhëtimi në Gjakovë i Ipeshkvit Mjeda nga Prizreni, i shoqëruar nga V. Konsulli në Prizren Poecel si përfaqësues i Monarkisë u bë mëse i nevojshëm, dhe e ndaloi përfundimisht gjëja krimet e xhandarmërisë malazeze. Në shkresë dërguar autoriteteve malazeze kërkohej për Mjedën dhe funksionarin i cili eventualisht do ta shoqërojë, respektin e duhur për pozitat e tyre dhe të deklarohen për siguri dhe vazhdimësinë e tij.

Më 23 prill 1913 Cetine, Nr, 161 notë verbale, në përgjigjen e shkresës nr. 505 të datës 26 mars të këtij viti e cila kishte për bazë informata të çfarëdo akuzimi serioz kundër Konsullit në Gjakovë, legata ka nderin të bëjë me dije, Qeverisë Mbretërore në përputhje me një raport telegrafik të zotëri Poecel, si vijon:

Posa konsujt dhe italianët kishin arritur në Gjakovë, një numër katolikë të konvertuar u paraqitën tek ta (në territor të pushtuar nga serbët) duke deklaruar që ishin detyruar të ndërrojnë fenë dhe duke i lutur ata t'i shpëtonin nga malazezët. Këta të mjerë larg mbylljes nga Konsulli, kaluan natën jashtë në pjesën serbe të qytetit të Gjakovës.<sup>18</sup>

Serbët dhe malazezët që e kishin pushtuar Kosovën deklarorin hapur se shqiptarët myslimanë duhej t'i shfarosim sepse kjo do ishte e vetmja mënyrë për të qetësuar vendin. Zotëri Tomiç, ish-sekretar i Pashiç kryeministrit serb, raportoi në udhëtimin e tij nga Prizreni për në Pejë, që në të dy anët e rrugës ai ka parë mbetjet e djegur nga fshatrat të cilat ishin bërë rrafsh më tokë. Rrugët ishin të veshur me trupat e shqiptarëve të cilët ishin varur në mënyrë çnjerëzore. Rrugët e Gjakovë dukeshin si një «avenju trekëmbëshash».<sup>19</sup> Në fshatin Bobaj në rrethin e Gjakovës, katër ushtarë serbë që ishin kapur duke u përpjekur të përdhunonin gratë, janë rrahur. Kjo ishte e mjaftueshme për një ekspeditë ndëshkuese që do të dërgohen në Bobaj ku të gjithë banorët u masakruan.

17 Arkivi i Kosovës, Fondi; Arkivi shtetëror i Parisit, Depeshetë e konsullit frëng në Shkodër.

18 Arkivi i Kosovës, Fondi; Arkivi shtetëror i Parisit, Depeshetë e konsullit frëng në Shkodër.

19 Leo Freundlich, *Golgota shqiptare, akuzat kundër shfarosësve të popullit shqiptar*, Tiranë, 1995, f. 52.

Gazetat më prestigjioze të kohës japin të dhëna të sakta mbi gjenocidin e ushtrisë dhe policisë malazeze ndaj popullatës shqiptare. Neue Frei Presse, në numrin e saj të datës 21 mars 1913 raportonte: jemi të informuar së katolikët dhe myslimanët shqiptarë janë duke u persekutuar për çdo ditë në rrethin e Gjakovës. Një pjesë e popullsisë ishte e detyruar të ikë duke lënë pas gjithë pasurinë. Rreth 300 persona në mesin e tyre gra dhe fëmijë të kërcënuar nga tytat e armeve u thonin: «ose do të nënshkruajnë deklaratën që ju jeni konvertuar në besimin e vërtet apo në të kundërtën ushtria do ta dërgoj shpirtin tuaj në ferr».<sup>20</sup> Gazeta «Reich Post» e datës 20 mars 1913 raporton, famullitarin në Gjakovë e kërcënojnë me likuidim nëse ai nuk do të heq dorë prej protektoratit austriak. Famullitarin e vranë për arsye se nuk pranoi të konvertohej nga feja katolike në atë ortodokse. Në prani të famullitarit, një numër i madh i burrave, grave dhe fëmijëve të kërcënuar dhe të lidhur me litar kërkohesh prej tyre që të konvertohen në fenë ortodokse. Ekspeditën e ndërrimit të fesë e udhëhoqi ushtria e shoqëruar nga prifti ortodoks.<sup>21</sup>

Gjakova është njëri ndër qytetet që ka vuajtur më së shumti nga forcat e ushtrisë malazeze. Gazeta «Vesnik Srpske Crkve», shkruante se serbet po i konvertojnë përmes dhunës katolikët shqiptarë në fenë ortodokse. Në letrën e dëshmitarit okular nga Gjakova, të datës 3 mars të vitit 1913, në përmbajtjen e saj shkruante: «Sot Gjakova ka përjetuar një ngjarje të jashtëzakonshme, në shtypin austriak kanë qarkulluar lajme se në Gjakovë po marshojnë 30. 000 shqiptarë për ta ndihmuar Shkodrën e rrethuar, e ne nuk pamë kurrfarë gjurme të kësaj ushtrie të organizuar. Por, nga kjo pamë krejt diçka tjetër: fshatra të tëra që kishin ardhur në Gjakovë për t'u konvertuar në fenë ortodokse». Në Gjakovë në pjesën malazeze para kapetanisë malazeze është mbledhur një pjesë e popullatës. Një numër prej 600 shpirtave, Prifti katolik nga Gjakova e kishte ftuar ipeshkvin e Prizrenit për t'i komunikuar lajmin së autoritete malazeze i kanë detyruar këta njerëz që përmes dhunës të braktisin fenë katolike. Pasi që erdhi nga Prizreni ipeshkvi me klerin e vet katolik, i cili u prit në mënyrë miqësore nga guvernatori krahinor malazez z. Plamenci, dhe ky i fundit ia jepi fjalën z. Ipeshkvit që ta pyes personalisht popullin a dëshironi me vullnetin e juaj ose është i detyruar në çfarëdo mënyre të kalojë në fenë ortodokse. Z. Plamenci e morri fjalën dhe ju drejtuar më fjalë të zgjedhura popullit: a dëshironi ta ndërroni fenë me vullnetin tuaj ?, mos ju ka detyruar dikush që ta bëni këtë ?, mos keni frikë prej dikujt ?. «Askush nuk na ka detyruar, madje as që ka folur, po shkojmë në tufën tonë. Duam që edhe

20 [www.albanianhistory.net/texts20...](http://www.albanianhistory.net/texts20...) AH1913\_1.ht...

21 Hakif Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995)*, Prishtinë, 1995, f. 66.

me fe të barazohemi me vëllezërit që na kanë çliruar», u përgjigj Andria Mihajloviqi.<sup>22</sup>

Gazeta «The New York Times» raporton se njerëzit janë të varur në trekëmbësh në të dy anët e rrugës, dhe se rruga për në Gjakovë ishte si një «luginë varjesh». Në Gjakovë u krye edhe konvertimi me forcë i katolikëve në fenë ortodokse serbe.

«Neue Frei Presse» e Vjenës më 20 mars 1913 raporton se shtatë Priftë ortodoks me ndihmën e ushtrisë i pagëzuan më dhunë rreth 300 katolikë në besimin ortodoksë.<sup>23</sup>

Gazeta «Dally Croniel» shkruante së rrugës nga Gjakova deri në Pejë gjatë nëntorit të vitit 1912, shiheshin njerëz të vranë dhe të therur në të dy anët e rrugës. Pas një kohe të shkurtër dy mujore në këto anë të Rrafshin të Dukagjinit pothuajse në të gjitha fshatrat ishin venë trekëndëshat për varje, e pastaj fshatrat ishin djegur në mas të madhe. Nëse varjet nuk do të jepnin efektin e kërkuar për ta nënshtruar popullatën shqiptare të kësaj ane atëherë filluan metodat çnjerëzore më anën e therjeve si mjet për t'i arritur qëllimet e tyre.<sup>24</sup>

Diplomati rus Sazanovi shkruan: kundër nesh po arrin ankesa nga të gjitha anët për arsye të qëndrimit tonë në viset e çliruara të banuara me shqiptar. Edhe gazetat më prestigjioze, siç është Times po raportojnë për krimet që i ka bërë ushtria dhe pushteti serb. I ka veçuar disa gjëra, raportin së vetëm në Gjakovë i kemi pushkatuar 300 persona, po ashtu në të njëjtin vend me anën e forcës i kemi konvertuar në fenë ortodokse 80 familje shqiptare.<sup>25</sup>

Në letrën e shkruar nga Shqipëria, «nga një garnizon i kufirit» Dimitrije Tucoviq Thotë: Gjakova është qytet i banuar më popullsi shqiptare, serbë janë një grusht njerëzish në një skaj të një mëhallë të serbëve. Edhe rrethina e Gjakovës është pothuajse ekskluzivisht e banuar me shqiptar.<sup>26</sup> Në letrën «Gjakmarrje Soldateskës» të atyre viteve të tmerrit: «Mbi popullin shqiptar të Pejës, të Gjakovës dhe Prizrenit fluturonte fantazma e vdekjes ditën e natën. Pasiguri ishte shumë e pranishme kudo në popull, kush binte në gjumë nuk ishte i sigurt se a do të zgjohej i gjallë në mëngjes».<sup>27</sup>

Malazezët pavarësisht nga krimet gjenocidiale të kryera gjatë Luftës së Parë Ballkanike, përmes dhunës dhe likuidimeve fizike në mars të vitit

22 Serbia e Shqiptarët, pasqyrë e politikës së Serbisë ndaj shqiptarëve prej vitit 1878 deri në vitin 1914, Libri i parë, Përkthim nga serbishtja i edicionit të revistës Časopis za kritiko znanosti, Ljubljana, 1989, Botimi I, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2011. f. 119-120.

23 sr.wikipedia.org/.../Злочини\_над\_Албанцима\_у\_...

24 Gazeta Shkëndija, e përjavshme arsimore-pedagogjike dhe shoqërore, Nr. 41/ viti XXI, Prishtinë, 1991, f. 16.

25 Hakif Bajrami, Si e okupoj Serbia Kosovën më 1912, 1, Prishtinë, 2003, f. 193.

26 Serbia e Shqiptarët, pasqyrë e politikës së Serbisë ndaj shqiptarëve prej vitit 1878 deri në vitin 1914..., f. 59.

27 Po aty f. 121.

1913 malazezët i konvertuan në rajonin e Gjakovës më shumë së 1703 shqiptarë në fenë ortodokse. Gjenocidi i forcave malazeze vazhdoi deri në fund të vitit 1915, kur Mali i Zi kapitulloi në janar të vitit 1916.<sup>28</sup> Një numër i caktuar i njerëzve që kundërshtuan të konvertoheshin, siç ishte rasti i Luigj Palaj i cili së bashku me 56 shqiptarë më 7 mars 1913 u vranë mizorisht në fshatin Janosh të Gjakovës. Ai u akuzua së gjëja po e nxit dhe organizon popullit për kryengritje. Ky akt mizor i kryer nga forcat malazeze shkaktojë indinjatë të madhe në mes të dy feve asaj katolike dhe myslimane.<sup>29</sup>

Edit Durham në veprat e saj shkruante: «Asnjë turk nuk i ka trajtuar ndonjëherë armenet më keq se sa i kanë trajtuar serbo-malazezët shqiptarët në emër të Kishës Ortodokse».<sup>30</sup>

Ata që e kundërshtuan dhe e luftuan pushtetin malazez përmes Lëvizjes Kaçake autoritetet malazeze i arrestonin dhe i merrnin peng anëtarët e familjes dhe i internonin në kampet e përqendrimit në Mal të Zi. Malazezet e morën si pretekst këtë dhe në Gjakovë i konvertuan 503 anëtarë të këtyre familjeve. Në territoret e pushtuara malazezët nuk e ndalen procesin e konvertimit dhe të shpërnguljeve të shqiptarëve me dhunë nga vendet e tyre deri ka fund vitit 1915.<sup>31</sup> Në fshatrat Dobriqe, Firajë dhe Novosellë e Poshtme të cilat gravitojnë në rrethin e Gjakovës u konvertua popullsia katolike ku deri në fund të shkurtit të vitit 1913 numri i të konvertuarve arriti deri në 41 familje. «Procesi i konvertimit tek shqiptarët ishte tejet i dhunshëm. njerëzit futeshin në ujin e ngrirë dhe i afronin tek zjarri deri sa të piqeshin. shpëtimi i vetëm i tyre ishte kalimi në fenë ortodokse».

Konvertimi i shqiptarëve të besimit islam e katolikë nga autoritetet malazeze shpesh herë shoqërohej dhe paguhej edhe me likuidime fizike. Gjenocidin që e kryen malazezët është tejet mizorë, njerëzve u vihej në kokë saçi i skuqur dhe në agoninë e jetës u prehej gishti i të vdekurit dhe në këtë mënyrë iu vinte në letër shenja. Vetëm në këtë mënyrë për të shpëtuar jetën dhe familjet e tyre «shprehen gatishmëri» për ta ndërruar fenë dhe me pastaj për t'u bërë malazezë. Shqiptarëve ua ndërronin edhe emrat për t'i paraqitur para opinionin evropian si malazezë. Nuk munguan as deklaratat e hartuara dhe të nënshkruar nga përfaqësues të organeve të pushtetit malazez së gjëja shqiptarët e pranonin konvertimin në mënyrë vullnetare.<sup>32</sup>

Shtypi i huaj me muaj të tërë ka shkruar për masakrat e tmerrshme që po i bënin malazezët ndaj shqiptarëve. Më dhjetëra-mjera njerëz krejtësisht

28 [www.ess.uwe.ac.uk/kosovo/chap2.htm](http://www.ess.uwe.ac.uk/kosovo/chap2.htm)

29 Zekeria Cana, *Kthimi i shqiptarëve me dhunë në fenë ortodokse më 1912-1913*. Dituria Islame Nr. 63. Prishtinë, 1994, f. 25.

30 Leo Freundlich, *Golgota shqiptare...*, f. 30.

31 Liman Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës...*, f. 73.

32 Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 29, 30.



të pafajshëm dhe të pambrojtur kaluan qafën nëpër tehun e thikës dhe bajonetës, gratë u përdhunuan, pleqtë dhe fëmijët u mbytën, fshatra të tërë u dogjën dhe u rrafshuan për toke. Për realizimin e këtyre krimeve u përdor vetëm gjuha e çizmes brutale e çnjerëzore të ushtrisë në mënyrë më mizore të mundshme. Një numër i madh i njerëzve janë therur si të ishin në kasaphane.<sup>33</sup>

Shqiptarët gjatë historisë i përballuan secilit pushtues duke i ruajtën më dinjitet tiparet e tyre krejtësisht të veçanta siç janë raca, gjuha doket dhe zakonet. Terrori që është ushtruar ndaj popullit shqiptar nuk ka mundur ta shfaros racën e tij të fortë. Pushtuesit malazez e pushtuan pjesën më të madhe të Rrafshit të Dukagjinit si armiq të popullit shqiptar edhe si armiq i lëshuan tokat shqiptare.

---

33 Leo Freundlich, *Golgota shqiptare...*, f. 39.

**Ma. Luan TETAJ**

**SUMMARY**

**MONTENEGRIN GENOCIDE OF 1913 IN GJAKOVA**

Montenegrin invaders in the beginning of the 20th century commenced a campaign of genocide against Albanians, aiming their assimilation and colonization of Albanian lands with Montenegrins. In Gjakova of 1913, invaders conducted crimes and abuses of innocent and unprotected population, through pressure and systematic violence converting Albanians to orthodox religion. Montenegrin army since the first day of invasion in the region of Dukagjini, especially in and around town of Gjakova, charged people to abandon their nationality by continual oppression made efforts to assimilate Albanian ethnicity.

During the course of history Albanians faced all invaders and defended with dignity their distinctive character of language, tradition and customs. Montenegrin invaders conquered most part of the region as the enemy of Albanian people and left Albanian lands as such. Terror against Albanians could not exterminate this enduring race of people.